



## Projekti: Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

### Këshillim mbi „Administrimin e procedurës së falimentimit – aspektet normative dhe praktika gjyqësore“

Më 21 mars në Shkup u mbajt këshillimi i tretë, nga gjithsej tetë këshillimet e parapara mbi procedurën e falimentimit. Në kuadër të temës „Administrimi i procedurës së falimentimit – aspektet normative dhe praktika gjyqësore“ janë përpunuar parimet themelore të procedurës së falimentimit, si dhe të drejtat dhe obligimet e gjykatësve të falimentimit, administratorëve të falimentimit dhe të komitetit të kreditorëve.

Këshillimi u mbajt në kuadër të projektit „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare,“ dhe në të morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, gjykatës falimentimi dhe gjykatës të cilët punojnë në lëndë që dalin nga procedura falimentuese, administratorë falimentimi, juristë, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera të interesuara.



Gjatë këshillimit u theksua se nga rreth gjithsej 1800 procedura të hapura falimentimi në vend, 1000 janë hapur paralelisht me fshirjen nga Regjistri Qendror me të drejtën zyrtare, pas informimit të DAP-it nga ana e Regjistrit Qendror të RM-së.

Edhe gjatë këtij këshillimi të tretë me radhë dedikuar procedurës së falimentimit, u nënvizua nevoja për harmonizim të metutjeshëm të kornizës ligjore me legjislacionin e BE-së, si dhe me praktikën e vendeve-anëtare. Kështu për shembull, për dallim nga legjislacioni maqedonas, në Gjermani nuk bëhet vetëm definimi i të drejtave dhe obligimeve të organeve në procedurën e falimentimit – fokusi është në rregullimin e mënyrës së përzgjedhjes së organeve të administrimit të falimentimit dhe të drejtave dhe obligimeve të tyre.

Projekti realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian dhe zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.

Shkup, 21.03.2017